

VENDIM
Nr. 570, datë 3.8.2016

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN, PËR INSTITUTIN E NDËRTIMIT, TIRANË,
TË OBJEKTIT NR. 2, ME SIPËRFAQE 458 m², KOMPONENT I PRONËS NR. 90, ME
EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 4400 (ISH-SHTABI I KML-së)”, ME
VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 88, DATË 30.1.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Institutin e Ndërtimit, Tiranë, për një periudhë 30-vjeçare, të objektit nr. 2, me sipërfaqe 458 (katërqind e pesëdhjetë e tetë) m², komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (Ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas plan-vendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur në funksion të veprimtarisë së Institutit të Ndërtimit, Tiranë.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban i ndalohet të ndryshojë destinacionin e objektit nr. 2, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Kulturës i hiqet nga përdorimi objekti nr. 2, me sipërfaqe 458 (katërqind e pesëdhjetë e tetë) m², sipas planimetrisë, komponent i pronës nr. 90, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4400 (Ish-Shtabi i KML-së)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, miratuar me vendimin nr. 88, datë 30.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, të objektit nr. 2, pjesë e pronës nr. 90, me emërtim “Shtabi i KML-së”, dhe të objekteve nr. 21 e nr. 35, pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Tufinë, Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes”.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës, ministri i Zhvillimit Urban, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi


PLANVENDOSJA E
PRONES Nr.90 (ISH SHTABI I K. M. L.) TIRANE

SISTEMI I KOORDINATAVE SHETERORE

581	403 950	404 000
350		

581
300





SHPJEGUESE

SIP. E PERGJITHESHME = 3493.6 m²

SIP. ME NDERTIME = 1402.3 m²


KUFIRI I REPARTIT

▨ sip.e objektit 2 = 433.1 m²

▨ sip.funksionale = 24.9 m²

Sip.e përgjithshme qe është dhënë në përdorim TKOB = 458.0 m²

Sip. e Katit Përdhe të objektit nr.1 = 681.5 m²



581
250

SHPIJEGJESE
SIP. E PERGJITHESHME = 3493.6 m²
SIP. ME NDERTIME = 1402.3 m²

KUFIRI I REPARTIT

- ☒ sip.e objektit 2 = 433.1 m²
- ☒ sip.funksionale = 24.9 m²

Sip.e pegjithshme qe është dhënë në perdorim TKOB = 458.0 m²

- Sip. e Katit Përdhe të objektit nr.1 = 681.5 m²
- Sip. e Katit parë të objektit nr.1 = 611.0 m²
- Sip. e Katit dytë të objektit nr.1 = 611.0 m²

Shënim:Kjo planvendosje u hartua sipas kërkesës së DMPA të MM, mbi bazën e dokumentacionit të marrë në arkivin e IGJIU

Qeshor 2016

4 581
200

4 403 900

403 950

404 000

PUNOI

Top.Nikoll TUSHI


SHKALLA 1 :500

DREJTORI IGJIU,
N/KoL.Ark. Ferdi HYRAJ

[Signature]

PLANIMETRIA E OBJEKTIT 2
 SIP e Nderimit.=680.8m2
 ZZZZ sip e ndertimit qe jepet ne perdorm nga objekti 2= 433.1m2
 SHKALLA 1:100

3686



REP. SHOIPERISE MIN. MBROJTJES I.G.J.U.	N/DREJTORI	Ing. Saimir BURBA
Rep Ushtr.K.M.I. Tirane(prona 90)	VIZATOI	Ing. A.JOCA
DATA 17/12/2012	PERPILOI	Ing. A.JOCA
	KONTROLLOI	Top.K.HYSENI